


# Zgjedhje në kohë pandemie

## Menaxhimi kundrejt Pasojave





# Zgjedhje në kohë pandemie

**Menaxhimi kundrejt Pasojave**

Prishtinë, mars 2021

---

E drejta e autorit © 2021. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të D4D-së.

Punim i përgatitur:

Blerinë Ukshini

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetje nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet pasqyrim i qëndrimit të Ambasadës Britanike në Prishtinë.

## Përmbajtja

Hyrje .....	5
Zgjedhjet, besimi i qytetarëve dhe ndikimi i COVID-19 .....	6
Organizimi i zgjedhjeve në kohë pandemie në vendet e rajonit .....	9
<i>Serbia</i> .....	10
<i>Maqedonia e Veriut</i> .....	11
<i>Mali i Zi</i> .....	13
A kishte kapacitet Kosova për organizimin e zgjedhjeve në kohë pandemie? .....	15
<i>Fushata zgjedhore</i> .....	18
<i>Vëzhgimi i zgjedhjeve</i> .....	22
<i>Organizimi i zgjedhjeve nga ana e KQZ-së</i> .....	24
Rekomandimet .....	27
Referencat .....	30

---

## Lista e tabelave

Tabela 1 . Planifikimi fillestar dhe zhvendosja e mbajtjes së zgjedhjeve në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të zi.....	10
Tabela 2. Të dhënat për shtetin e Serbisë në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, dalën në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve. ....	11
Tabela 3. Të dhënat për shtetin e Maqedonisë së Veriut në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, dalën në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve. ....	13
Tabela 4. Të dhënat për shtetin e Malit të zi në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, daljen në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve.....	14
Tabela 5. Situata me COVID-19 sipas periudhave .....	17
Tabela 6. Numri i rasteve pozitive me COVID-19 në periudha të ndryshme(sipas rajoneve) .....	20
Tabela 7. Numri i vëzhguesve të akredituar në zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2017 dhe 2019 dhe 2021.....	23

## Hyrje

Pandemia Covid-19 ka ndryshuar rrjedhën e funksionimit të shumë shteteve në të gjitha fushat. Përveç dëmeve shëndetësore dhe socio-ekonomike që padyshim janë më të mëdhatë në këtë mes, situata ka ndikuar edhe në zhvillimet politike e institucionale, sidomos tek vende të cilat kanë pasur një vit zgjedhor, në nivel nacional apo atë lokal. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë për ndikimin e pandemisë Covid-19 në organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve, duke përfshirë rrezikun për përhapje të virusit. Dokumenti përfshinë rëndësinë e mbajtjes së zgjedhjeve si formë demokratike për qeverisje, praktikat nga shtetet e rajonit të cilat kanë mbajtur zgjedhjet në vitin 2020, si dhe analizimin e kapaciteteve të Kosovës për organizimin e tyre në kohë pandemie.

Po ashtu, një pjesë e rëndësishme padyshim që janë rekomandimet, në bazë të të cilave Subjektet Politike, Kandidatët për Anëtarë të Kuvendeve të Komunave, Elektorati, Vëzhguesit e Akredituar dhe Institucionet që merren me organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve duhet t'i kenë parasysh në zgjedhjet e ardhshme në nivel lokal të cilat do të organizohen po këtë vit, në kohë pandemie.

Përgatitja e këtij dokumenti u bë në bazë të analizimit të të dhënave zyrtare nga shtetet që kanë mbajtur zgjedhjet gjatë kohës së pandemisë Covid-19, raporteve nga organizata nacionale, analizimin e të dhënave statistikore për rastet pozitive me Covid-19 nga të dhënat e IKPSHK-së si dhe monitorimin e vazhdueshëm të fushatës elektorale dhe aktiviteteve të tjera në kuadër të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës të cilat u mbajtën me 14 shkurt 2021.

## Zgjedhjet, besimi i qytetarëve dhe ndikimi i COVID-19

Zgjedhjet janë një nga instrumentet më të fuqishme që proklamojnë demokracinë e një vendi, duke u mundësuar qytetarëve që me anë të votës së tyre të lirë, të barabartë dhe të fshehtë të vendosin për përfaqësimin e qeverisjes, si në nivel lokal po ashtu edhe nacional. Varësisht nga praktikat e shteteve, sistemi zgjedhor ka forma të ndryshme të organizimit dhe lloje të ndryshme të zgjedhjeve. Republika e Kosovës është sistem parlamentar, ku zgjedhja e deputetëve bëhet me anë të votës së qytetarëve në lista të mbyllura, për një mandat të rregullt katër vjeçar. Ndërsa sa i përket nivelit lokal, elektoratit u ofrohet mundësia të votojnë për të parin e Komunës në njërin fletëvotim ndërsa për anëtarët e Kuvendit të Komunës në një fletëvotim tjetër. Edhe mandati i rregullt i Kryetarit poashtu i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër vjet, me mundësi rizgjedhje për mandatet e ardhshme. Të gjitha këto janë të rregulluara me anë të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Përveç dy ligjeve të lartëcekura, procedurat zgjedhore në Kosovë parashihen dhe rregullohen edhe me rregullat zgjedhore të miratuara nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), e të gjitha këto janë në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik në vend. Përveç ligjeve dhe rregulloreve, sa i përket organizimit të zgjedhjeve, institucionet shtetërore kanë nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit për procesin zgjedhor të nënshkruara nga: Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), Prokurori i Shtetit (PSh), Policia e Kosovës (PK), Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Ky bashkëpunim ka filluar nga viti 2013, duke u përditësuar në vitin 2016 si dhe së fundmi në muajin shtator të vitit 2020, ku pjesë e



memorandumit është shtuar edhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). Qëllimi i këtij memorandum, të iniciuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), ishte ngritja e nivelit të besueshmërisë së qytetarëve, rritja e transparencës dhe koordinimi ndërinstytucional më i ngushtë dhe funksional<sup>1</sup>.

Zgjedhjet vlerësohen si një nga instrumentet më demokratike për qeverisje dhe rëndësia e tyre është e padiskutueshme, pasi që vë në garë subjektet e ndryshme politike dhe u lë në vullnetin e popullit zgjedhjen e tyre. Mirëpo, sa ishin të gatshme institucionet shtetërore në Kosovë të menaxhojnë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në kohë të pandemisë në njërën anë dhe subjektet me fushatat e tyre zgjedhore në anën tjetër, kjo gjë la për të dëshiruar në aspektin e mbrojtjes nga Covid-19.

Shpallja e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës dhe caktimi i datës 14 shkurt 2021 si dita e mbajtjes së tyre u caktua nga Ushtruesja e Detyrës së Presidentes së Kosovës me datën 6 janar 2021. Meqë parafushata nuk është e rregulluar me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe as rregulloret e KQZ-së, partitë politike dhe anëtarët e tyre që nga ajo kohë filluan me fushatën e tyre jo zyrtare. Mediat raportonin për fushatë derë më derë, takime edhe në grupe më të mëdha përkundër masave të vendosura nga qeveria në detyrë. Përfillja e masave nuk u bë nga asnjë subjekt politik, madje as nga subjekti politik i cili mori vendimin për këto masa. Marrë parasysh periudhën kohore, dita e zgjedhjeve e njohur edhe si “DITA Z” u menaxhua shumë më mirë sesa para-fushata dhe fushata zgjedhore.

Rëndësia e besimit të qytetarëve në ciklin e procesit zgjedhor është shumë e madhe, pasi që determinon daljen në zgjedhje e cila e reflekton edhe funksionimin e një vendi për mandatin

---

<sup>1</sup> <https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkruhet-memorandum-i-bashkepunimit-per-procesin-zgjedhor/>

---

që thirren zgjedhjet. Andaj, në kohë pandemie do duhej (dhe padyshim që do të duhet për zgjedhjet lokale të këtij viti) që të analizohen kapacitetet për menaxhim të situatës, të ketë koordinim ndërinstytucional dhe të këshillohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe IKPSHK nëse kushtet e krijuara janë në përputhje me rregullat dhe vendimet e tyre për masat kundër përhapjes së Covid-19. Në këtë rast, në Kosovë duhet që të krijohet një task forcë për menaxhimin e zgjedhjeve në kohë pandemie, e cila do të përfshijë ekspertë të ndryshëm rreth hartimit të planit të veprimit, monitorimit dhe zbatimit të tij. Kjo task forcë përveç që do të shërbej për zgjedhjet lokale që do të mbahen në vjeshtë të këtij viti, do të jetë orientuese edhe për të ardhmen se si të veprohet në situata të ngjashme.

## Organizimi i zgjedhjeve në kohë pandemie në vendet e rajonit

Nëse analizojmë statistikën botërore në lidhje me zgjedhje, në bazë të raporteve të Institutit për Demokraci dhe Ndihmë Zgjedhore<sup>2</sup> deri në fund të muajit tetor 2020, 74 shtete kanë organizuar zgjedhjet ku prej tyre 36.5 % ishin shtete në pjesën e Evropës dhe Ballkanit Perëndimor. Edhe pse organizimi i tyre u shtye për një periudhë të caktuar për shkak të rritjes së numrit të rasteve dhe krizave shëndetësore që shtetet pësuan, ato në shumicën e vendeve u mbajtën gjatë po të njëjtit vit.

Edhe shtetet e rajonit si: Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, kishin një vit zgjedhor. Sikurse vendet tjera të Evropës edhe këto morën vendim për shtyrje për një kohë të caktuar të mbajtjes së zgjedhjeve. Serbia kishte të planifikuar t'i organizoj zgjedhjet fillimisht me datë 26 prill 2020, ndërsa i zhvendosi më 21 qershor 2020; Maqedonia e Veriut në situatë të zakonshme do të mbante zgjedhjet më 12 prill 2020, ndërsa zhvendosi organizimin e tyre më 15 korrik 2020; po ashtu edhe Mali i Zi planifikonte mbajtjen e zgjedhjeve me datën 5 prill ndërsa i mbajti më 30 gusht 2020. Këto ndryshime të datave erdhën si shkak i numrit të rasteve pozitive me Covid-19 të shtetasve dhe banorëve të tyre.

---

<sup>2</sup> <https://www.idea.int/news-media/multimedia-reports/global-overview-covid-19-impact-elections>

	<b>Fillimisht të planifikuara më</b>	<b>U zhvendosën dhe mbajtën më</b>
<b>Serbia</b>	26 prill 2020	21 qershor 2020
<b>Maqedonia e Veriut</b>	12 prill 2020	15 korrik 2020
<b>Mali i zi</b>	5 prill 2020	30 gusht 2020 <sup>2</sup>

*Tabela 1 . Planifikimi fillestar dhe zhvendosja e mbajtjes së zgjedhjeve në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të zi.*

## Serbia

Serbia ishte shteti i parë në Ballkan që organizoi zgjedhje në kohë të pandemisë Covid-19, ku me datën 21 qershor 2020 organizuan zgjedhjet parlamentare. Edhe pse në kohë pandemie, zgjedhjet nuk është se ndryshuan shumë sa i përket mënyrës së organizimit, ato u mbajtën vetëm një ditë, dhe periudha kohore e votimit ishte si në të kaluarën<sup>3</sup> nga ora 07:00 në mëngjes deri në 20:00 në mbrëmje<sup>4</sup>. Dalja në këto zgjedhje nga elektorati ishte 7.77% më e vogël sesa në zgjedhjet paraprake ku dalja në zgjedhje kishte shënuar 56.07%<sup>5</sup>, ndërsa në këto zgjedhje arriti një përqindje prej 48.93%<sup>6</sup>. Për shkak të pandemisë dhe menaxhimit më të mirë, të mos grumbullimit të shumë personave në një vendvotim, numri i vendvotimeve u shtua nga 8,377<sup>7</sup> në 8386<sup>8</sup>. Mirëpo, përkundër shtimit të vendvotimeve, përdorimit të maskave dhe dezinfektuesve, numri i rasteve pozitive me Covid-19 për

<sup>3</sup>

[https://www.ifes.org/sites/default/files/2016\\_ifes\\_serbia\\_parliamentary\\_election\\_s\\_faqs.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/2016_ifes_serbia_parliamentary_election_s_faqs.pdf)

<sup>4</sup>[https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes\\_faqs\\_elections\\_in\\_serbia\\_2020\\_parliamentary\\_elections\\_june\\_2020.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes_faqs_elections_in_serbia_2020_parliamentary_elections_june_2020.pdf)

<sup>5</sup> <https://www.idea.int/data-tools/country-view/253/40>

<sup>6</sup> <https://www.idea.int/data-tools/country-view/253/40>

<sup>7</sup> <https://crta.rs/wp-content/uploads/2018/03/PRELIMINARY-REPORT-ON-THE-ELECTION-DAY-OBSERVATION-2016.pdf>

<sup>8</sup> <https://www.dw.com/sq/zgjedhjet-parlamentare-t%C3%AB-serbis%C3%AB-mbahen-edhe-n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-53880547>

dy javë u shtua për 3,328, ku nga 12,803<sup>9</sup> sa ishte numri i të rezultuarve pozitiv me Covid-19, pas dy javëve të mbajtjes së zgjedhjeve ky numër arriti në 16,131 të infektuar<sup>10</sup>.

## Serbia

Rastet me Covid-19 para mbajtjes së zgjedhjeve	12.803
Rastet me Covid-19 dy javë pas mbajtjes së zgjedhjeve	16.131
Dalja në zgjedhjet paraprake	3,778,923 (56.07%)
Dalja në zgjedhje gjatë pandemisë Covid-19	3,221,908 (48.93%)
Orari për votim para pandemisë	07:00 - 20:00
Orari për votim gjatë pandemisë	07:00 - 20:00
Numri i vendvotimeve para pandemisë	8,377
Numri i vendvotimeve gjatë pandemisë	8,386

*Tabela 2. Të dhënat për shtetin e Serbisë në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, dalën në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve.*

## Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut ka mbajtur zgjedhjet parlamentare në datat 13, 14 dhe 15 korrik 2020. Organet kompetente njoftuan se mbajta e zgjedhjeve do të bëhej me masa shtesë dhe se shëndeti i qytetarëve nuk do të rrezikohet. Në bazë të analizimit të situatës, mbajtja e zgjedhjeve në Maqedoni të Veriut nuk është zhvilluar një ditë, siç ka qenë praktikë gjithmonë, por është zhvilluar me procedurë të zgjatur për tre ditë me radhë. Në ditën e parë të zgjedhjeve (13 korrik) kanë votuar personat që kanë qenë të vetë izoluar për shkak se kanë

<sup>9</sup> <https://www.worldometers.info/coronavirus/country/serbia/>

<sup>10</sup> <https://www.worldometers.info/coronavirus/country/serbia/>

rezultuar pozitiv me Covid-19 gjatë asaj kohe; në ditën e dytë (14 korrik) kanë votuar personat e sëmurë, dhe të gjithë personat e tjerë votimi i të cilëve zhvillohet sipas Kodit Zgjedhor të vendit ndërsa në ditën e tretë (15 korrik) kanë votuar pjesa tjetër e popullsisë të cilët nuk ishin testuar apo rezultuar pozitiv me Covid-19. Përveç zgjatjes së ditëve, organet kompetente vendosën që të zgjasin edhe orën e votimit, ku praktikë e së kaluarës ishte votimi deri në orën 19:00<sup>11</sup> ndërsa në këto zgjedhje, qytetarët patën mundësi ta shfrytëzojnë të drejtën për të votuar deri në orën 21:00<sup>12</sup>. Përkundër zgjatjes së orarit dhe ditëve, numri i vendvotimeve në këto zgjedhje ishte për 44 më i vogël për shkak të respektimit të masave të pandemisë. Megjithëse kohëzgjatja e mbajtjes së zgjedhjeve ishte shumë më e madhe, ndikimi i pandemisë dhe frika për infektim u vërejt mjaft shumë nga qytetarët. Dalja në zgjedhje ishte për 14.77 % më e ulët sesa në ato paraprake. Në vitin 2016 pjesëmarrja në zgjedhje ishte 66.79%<sup>13</sup>, ndërsa gjatë këtyre zgjedhjeve në vitin 2020 dalja në zgjedhje ishte 52.02%. Përkundër marrjes së masave të nevojshme, trajektorja e rasteve pozitive të të infektuarve me Covid-19 është rritur. Para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale në Maqedoni të Veriut ishin gjithsej 8332<sup>14</sup> persona që kishin rezultuar pozitiv, ndërsa dy javë pas mbajtjes së zgjedhjeve numri total ishte 10,504<sup>15</sup> të infektuar, ose 2,172 specifikisht pas datës së zgjedhjeve. Megjithëse nuk mund të themi se këto raste janë posaçërisht për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve, përsëri numri i të infektuarve për një periudhë të shkurtë dhe dalja në zgjedhje e 943,750 personave mund të jenë njëri nga faktorët e rritjes së rasteve.

---

<sup>11</sup> <https://www.dw.com/sq/maqedoni-e-veriut-hapen-votimet-p%C3%ABr-zgjedhjet-parlamentare/a-54154841>

<sup>12</sup> <https://www.aa.com.tr/en/europe/n-macedonia-holds-snap-polls-amid-pandemic/1909817>

<sup>13</sup> <https://www.idea.int/data-tools/country-view/207/40>

<sup>14</sup> <https://koronavirus.gov.mk/stat>

<sup>15</sup> <https://koronavirus.gov.mk/stat>

## Maqedonia e Veriut

Rastet me Covid-19 para mbajtjes së zgjedhjeve	8332
Rastet me Covid-19 dy javë pas mbajtjes së zgjedhjeve	10504
Dalja në zgjedhjet paraprake	1,191,851 (66.79%)
Dalja në zgjedhje gjatë pandemisë Covid-19	943,750 (52.02%)
Orari për votim para pandemisë	07:00-19:00
Orari për votim gjatë pandemisë	07:00-21:00
Numri i vendvotimeve para pandemisë	3,524
Numri i vendvotimeve gjatë pandemisë	3,480

*Tabela 3. Të dhënat për shtetin e Maqedonisë së Veriut në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, dalën në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve.*

## Mali i Zi

Mali i Zi së fundmi, me datën 30 gusht 2020, organizoi zgjedhjet parlamentare. Sikurse në Serbi, edhe në Mal të Zi zgjedhjet u mbajtën në një ditë të vetme dhe nuk u pasqyruan praktikrat e Maqedonisë së Veriut për mbajtjen e zgjedhjeve tre ditë me radhë. Dallimi i vetëm ishte në zgjatjen e orarit për të votuar, ku nga 13 orë sa ishte praktika nga zgjedhjet e kaluara<sup>16</sup> ato i zhvilluan për 14 orë, pasi që vendvotimet u hapën në ora 07:00 në mëngjes ndërsa u bë mbyllja e tyre në ora 20:00<sup>17</sup>. Përveç zgjatjes së orarit për të shfrytëzuar të drejtën e votimit, u bë edhe shtimi i vendvotimeve të tjera nga

<sup>16</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/3/d/295511.pdf>

<sup>17</sup> [https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes\\_faqs\\_elections\\_in\\_montenegro\\_2020\\_parliamentary\\_elections\\_august\\_2020.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes_faqs_elections_in_montenegro_2020_parliamentary_elections_august_2020.pdf)

1,199 sa ishin në zgjedhjet e fundit, në 1217. Përkundër që në Serbi dhe Maqedoni të Veriut dalja në zgjedhje ishte dukshëm më e vogël në këto zgjedhje, në Mal të Zi ndodh e kundërta, pasi që kishte një rritje prej 3.24 % të qytetarëve që shfrytëzuan të drejtën e tyre për të votuar. Konkretisht, në zgjedhjet paraprake votuan 38,8220 persona apo 73.41 %<sup>18</sup>, ndërsa në këto zgjedhje 41,3952 persona apo 76.65 %<sup>19</sup>. Sa i përket rasteve pozitive me Covid-19, në krahasim me ditën e zgjedhjeve dhe dy javë pas mbajtjes së tyre kishte një rritje të numrit të përgjithshëm prej 1,985, apo nga 4,727<sup>20</sup> sa ishin para mbajtjes së zgjedhjeve në 6,712<sup>21</sup> raste pozitive dy javë pas mbajtjes së tyre.

## Mali i zi

Rastet me Covid-19 para matjes së zgjedhjeve	4,727
Rastet me Covid-19 dy javë pas mbajtjes së zgjedhjeve	6,712
Dalja në zgjedhjet paraprake	388,220 (73.41%)
Dalja në zgjedhje gjatë pandemisë Covid-19	413,952 (76.65%)
Orari për votim para pandemisë	07:00-19:00
Orari për votim gjatë pandemisë	07:00-20:00
Numri i vendvotimeve para pandemisë	1,199
Numri i vendvotimeve gjatë pandemisë	1,217

*Tabela 4. Të dhënat për shtetin e Malit të zi në lidhje me menaxhimin e zgjedhjeve, daljen në zgjedhje dhe rastet me Covid-19 para dhe dy javë pas zgjedhjeve.*

<sup>18</sup> [http://archive.ipu.org/parline/reports/2385\\_E.htm](http://archive.ipu.org/parline/reports/2385_E.htm)

<sup>19</sup> <https://www.idea.int/data-tools/country-view/203/40>

<sup>20</sup> <https://www.worldometers.info/coronavirus/country/montenegro/>

<sup>21</sup> <https://www.worldometers.info/coronavirus/country/montenegro/>



## **A kishte kapacitet Kosova për organizimin e zgjedhjeve në kohë pandemie?**

Në Kosovë, edhe pse viti 2020 nuk ishte një vit zgjedhor, për shkak të ndryshimeve politike si rrjedhojë e zgjedhjeve të tetorit të vitit 2019 dhe vonesave të krijimit të qeverisë deri në fillim të vitit 2020, në dy nga komunat e saj duhej të mbaheshin zgjedhje për kryetar të komunave. Konkretisht, Komuna e Podujevës dhe Komuna e Mitrovicës së Veriut, kishin mbetur pa kryetarë të komunave për shkak të dorëheqjes së kryetarëve, me rastin e emërimit të tyre si ministra në Qeverinë e Kosovës.

Rrjedha e situatës me Covid-19, pamundësoi mbajtjen e zgjedhjeve në këto dy komuna edhe pas vendimit nga Presidenti i Kosovës, si personi përgjegjës për shpalljen e zgjedhjeve, në bazë të kompetencave që mbartë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës. Në bazë të konsultimit dhe rekomandimeve nga IKPSHK dhe Ministria e Shëndetësisë, u mor vendim që këto zgjedhje të shtyhen për një afat të pacaktuar deri në normalizim të situatës. Gjithsesi, edhe pse ende situata me pandeminë nuk ishte stabilizuar dhe vendi po përballej me një valë të dytë dhe rikthim të numrave enorm me raste pozitive me Covid-19, Presidenti i atëhershëm i vendit mori vendim që zgjedhjet në këto dy komuna të mbaheshin me datën 29 nëntor 2020.

Në kohën kur u mor vendimi për shtyrjen e zgjedhjeve në këto komuna (14 mars 2020) në Kosovë ishin shumë pak raste aktive me Covid-19, ndërsa kur është marrur vendimi për mbajtjen e tyre, çdo ditë po shënoheshin mbi 500 raste pozitive në të gjithë Kosovën, duke i përfshirë edhe dy nga komunat ku u mbajtën zgjedhjet lokale. Ndër të tjera, Komuna e Podujevës po cilësohej si zonë e kuqe, apo zonë me rrezik më të lartë për përhapje të virusit për shkak të rritjes së rasteve aktive. Gjatë periudhës parazgjedhore ishin rreth 400

raste aktive në këtë Komunë dhe mbi 700 të shëruar. Ndërsa që nga data 19 nëntor 2020 (10 ditë para zgjedhjeve) deri më datën 9 dhjetor 2020 (10 ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve) u shtuan 569 raste të reja.

Megjithëse fushata zgjedhore nga kandidatët për Kryetar të Komunës u bë në grupe më të vogla – derë më derë dhe pa tubime të mëdha elektorale në ditën e zgjedhjeve në shumicën e vendotimeve nuk u përfillën vendimet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëzimi Administrativ nr.03/2020 për masat mbrojtëse për parandalimin e infektimit me COVID-19 për votuesit dhe stafin zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, të miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor me datën 17 nëntor 2020. Ndër masat kryesore të cilat u shpërfillën ishin mos-mbajtja e maskës në mënyrë të rregullt, duke mbuluar hundën dhe gojën, mos-mbajtja e distancës prej 1.5 metër me të tjerët si dhe mos-dezinfektimi i duarve pas votimit.

Kjo do duhej të ishte një pasqyrë e qartë për institucionet shtetërore dhe subjektet politike se si të veprohet në zgjedhjet e ardhshme, të cilat nuk vonuan shumë dhe në fillim të vitit, me datën 6 janar 2020, u shpallën nga Ushtuesja e Detyrës së Presidentes. Zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës u mbajtën me 14 shkurt 2021 dhe me gjithë vlerësimin për zgjedhje të lira dhe demokratike sa i përket procesit të votimit, nuk është që nuk ndikuan në rritjen e numrit të rasteve të reja me COVID-19 në vend.

	<b>Raste të reja</b>	<b>Raste të shëruara</b>	<b>Aktiv total</b>	<b>Numri i testeve</b>
Fillimi i vitit 2021	174	445	51,502	1,224
Shpallja e Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës	301	457	52,634	1,459
Fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore	341	207	61,086	2,357
Dita e Zgjedhjeve	246	201	64,341	3,031
Dy javë pas përfundimit të fushatës zgjedhore	445	264	68,351	2,570
Dy javë pas ditës së zgjedhjeve	453	206	69,230	3,680
Një muaj pas fillimit të fushatës zgjedhore	568	295	70,753	2,532

*Tabela 5. Situata me COVID-19 sipas periudhave*

Kosova kishte nisur një vit të ri të mbarë sa i përket situatës me pandeminë COVID-19. Me datën 1 janar 2021 nga 1,224 teste kishin rezultuar vetëm 174 persona pozitiv ndërsa ishin shëruar 445 të tjerë, përdërisa ishin 51,502 raste aktive në total në nivel vendi. Pak ditë më vonë, me datën 6 janar kur edhe u bë shpallja e zgjedhjeve të parakohshme, nga 1,459 teste ishin 301 raste të reja, 457 të shëruar ndërsa numri totali i personave arriti në 52,634. Me datën 3 shkurt kur edhe filloi

fushata zyrtare zgjedhore ishin nga 2,357 teste rezultuan pozitiv 341 persona, 2017 raste të shëruara dhe 61,086 raste aktive në total. Në ditën e zgjedhjeve më 14 shkurt 2021 nga 3,031 testime rezultuan pozitiv 246 persona dhe 201 të tjerë u shëruan, kurse numri i rasteve aktive vetëm se po rritej më shumë nga dita në ditë me ç'rast arriti në 64,341. Ndikimi që kishte fushata zgjedhore kishte filluar të reflektonte edhe në rastet pozitive me Covid-19 dy javë më pas ku me datën 26 shkurt nga 2,570 teste ishin gjithsej 445 raste të reja, 264 të shëruar ndërsa numri i përgjithshëm i rasteve aktive ishte 68,351. Ndërsa dy javë pas mbajtjes së zgjedhjeve me 28 shkurt nga 3,680 testeve, që njëkohësisht ishte edhe numri më i madh i testeve në këto periudha, rezultuan pozitiv 453 persona, 206 të tjerë u shëruan ndërsa numri total ishte 69,230. Me datën 3 mars, një muaj pas datës kur kishte filluar fushata zgjedhore, megjithëse numri i testeve ishte më i vogël gjithsej 2,532 rezultuan pozitiv 568 persona, u shëruan 295 të tjerë ndërsa numri total i personave aktiv me Covid-19 arriti në 70,753. Statistikat nga IKSHPK nuk përfshinë të dhënat nga komunat me shumicë serbe.

Këto shifra dëshmojnë edhe njëherë ndikimin që kishte mbajtja e zgjedhjeve në kohë të pandemisë COVID-19 e me theks të veçantë fushata zgjedhore e cila mblodhi në shumë komuna numër të madh të simpatizantëve pothuajse në të gjitha komunat.

## Fushata zgjedhore

Përveç ditës së zgjedhjeve, fushata zgjedhore është njëra nga çështjet më të rëndësishme sa i përket procesit zgjedhor. Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike është e rregulluar me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në kreun VII. Neni 44, Dispozitat e përgjithshme specifikojnë se subjektet politike kanë të drejtë: a) të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre

me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre; b) të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore; dhe c) të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues, në pajtim me rregullat e KQZ-së dhe ligjet tjera në fuqi.<sup>22</sup>

Pika A e këtij neni rezultoi që në kohë pandemie të ishte një e drejtë jo në favor të shëndetit publik të përgjithshëm. Fushata zgjedhore nga subjektet politike nuk u bë në përputhje me vendimet për masat mbrojtëse nga pandemia COVID-19. Subjektet politike si tërësi e as kandidatët/et për deputet/e nuk respektuan distancën sociale, bartjen e maskave dhe përdorimin e dezinfektuesve. Megjithëse në bazë të vendimeve nga Qeveria e Kosovës në Detyrë, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, në hapësira të mbyllura lejoheshin vetëm 30 persona ndërsa në vende të hapura vetëm 50 persona, numri i simpatizantëve në takimet e mbajtura në Komuna me ftesë të subjekteve ishte shumëfish më i madh. Përveç thirrjeve për takime nga ana e subjekteve politike edhe në takimet me kandidat/e të caktuar në shtëpi e restorante ishte poashtu jashtë çdo vendimi të ndërmarrë kundër pandemisë COVID-19.

---

<sup>22</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

---

	<i>Rajoni i Prishtinës</i>	<i>Rajoni i Mitrovicës</i>	<i>Rajoni i Pejës</i>	<i>Rajoni i Prizrenit</i>	<i>Rajoni i Ferizajit</i>	<i>Rajoni i Gjilanit</i>	<i>Rajoni i Gjakovës</i>	<b>Totali i rasteve të reja</b>
Fillimi i vitit 2021	100	26	4	11	15	13	5	174
Shpallja e Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës	194	31	19	12	18	12	15	301
Fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore	164	32	19	78	14	20	14	341
Dita e Zgjedhjeve	137	18	30	20	1	14	26	246
Dy javë pas përfundimit të fushatës zgjedhore	229	34	42	41	16	34	49	445
Dy javë pas ditës së zgjedhjeve	242	30	52	37	13	40	39	453
Një muaj pas fillimit të fushatës zgjedhore	310	51	48	20	29	63	47	568

*Tabela 6. Numri i rasteve pozitive me COVID-19 në periudha të ndryshme (sipas rajoneve)*

Numri më i madh i rasteve pozitive me COVID-19 gjatë periudhave: Fillimi i vitit 2021; Shpallja e Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës; Fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore; Dita e Zgjedhjeve; Dy javë pas përfundimit të fushatës zgjedhore; Dy javë pas ditës së zgjedhjeve dhe një muaj pas fillimit të fushatës zgjedhore, ishte në Rajonin e Prishtinës më pas Rajoneve të Mitrovicës, Prizrenit dhe Pejës. Në raste të caktuara edhe Gjilanit dhe Gjakovës.

Duke pasur parasysh që në vjeshtë të këtij viti do të mbahen edhe zgjedhjet lokale, numri i kandidatëve për anëtarë të Kuvendeve të Komunave do të jetë shumë më i madh sesa ai që ishte për Deputet/e të Kuvendit të Kosovës. Andaj, për raste të tilla institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me subjektet politike duhet të krijojnë një plan strategjik të përshtatshëm për të gjitha palët, duke mos e dëmtuar demokracinë e subjekteve politike për të bërë fushatë zgjedhore por as duke mos rrezikuar shëndetin e përgjithshëm. Një strategji e tillë duhet të mendohet të jetë afatgjate, që në raste të ngjashme të pandemisë apo gjendjeve të jashtëzakonshme në të ardhmen të jenë të gatshme për t'u zbatuar. Njëri nga opsionet që mund të zhvillohet fushata e subjekteve politike është të zhvillohet online, duke i shfrytëzuar mediat e reja dhe mediat tradicionale, pjesëmarrja në debate publike, reklamimi në portale, billbordet, caktimi i një numri minimal të personave në takime, gjithmonë në përputhje me masat e qeverisë, dhe anulimi i të gjitha tubimeve të mëdha.

Gjithsesi, duke marr parasysh grup moshat e ndryshme në Kosovë dhe shpërndarjen e personave në vise të ndryshme, jo gjithmonë elektorati ka qasje në të ashtuquajturën fushatë online. Andaj në mënyrë që mos të penalizohen subjektet politike dhe zgjedhjet të jenë sa më demokratike dhe legjitime, vendimet e Komisionit Qendror Zgjedhor duhet të jenë në përputhje me ligjin për zgjedhje por edhe me

rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë. Në këtë rast të mënjanohej tubimet e mëdha, të ketë numër të kufizuar të njerëzve në takime fizike si dhe të respektohen të gjitha vendimet tjera në fuqi si mbajtja e maskës në mënyrë të rregullt e distanca sociale si dy ndër masat kryesore për mbrojtje nga pandemia Covid-19.

## Vëzhgimi i zgjedhjeve

Vëzhgimi i procesit zgjedhor nga afër është i lejuar në të gjitha zgjedhjet. Në këtë proces poashtu marrin pjesë një numër shumë i madh i organizatave të ndryshme vendore apo ndërkombëtare. Akreditimin e vëzhguesve e bën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ku fillimisht përcakton afatet për aplikim dhe pas shqyrtimit të dokumenteve votohen nga anëtarët e KQZ-së.

Numri i vëzhguesve nga viti zgjedhor në atë pasues ka pasur rritje kjo sidomos nëse krahasojmë tre palë zgjedhjet paraprake. Në vitin 2017 janë mbajtur dy palë zgjedhje, në qershor zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës dhe në tetor zgjedhjet lokale. Edhe brenda këtij viti kishte rritje të numrit të vëzhguesve ku në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës ishin gjithsej 29,722 vëzhgues ndërsa në zgjedhjet lokale 33,863 vëzhgues. Rritje më të madhe të vëzhguesve kishte në tetor të vitit 2019 ku KQZ akreditoi në total 35,103 të tillë. Ndërsa në zgjedhjet e këtij viti nga KQZ u akredituan një numër më i vogël në krahasim me 3 palë zgjedhjet paraprake. KQZ akreditoi gjithsej 29,200 vëzhgues ku prej tyre numri më i madh ishte nga subjektet politike të cilat akredituan 26,635 vëzhgues, apo 8210 vëzhgues më shumë. Numër më të vogël të vëzhguesve në krahasim me ato paraprake kishin organizatat vendore për 2441 më pak si dhe organizatat ndërkombëtare minus 236 vëzhgues.



### **Totali i vëzhguesve të akredituar në zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

	<b>2017</b>	<b>2019</b>	<b>2021</b>
Ambasada	161	154	146
Organizata ndërkombëtare	300	273	37
Organizata vendore	8,892	4,154	1,713
Parti Politike	4,049	18,425	26,635
Koalicione	15,788	11,457	0
Institucione Ndërkombëtare	27	0	0
Institucion Vendor	1	0	43
Media Vendore/ndërkombëtare	504	622	626
Kandidat të pavarur	0	17	0
Konsullatë	0	1	0
Inicativë	0	0	0
	<b>29,722</b>	<b>35,103</b>	<b>29,200</b>

*Tabela 7. Numri i vëzhguesve të akredituar në zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2017 dhe 2019 dhe 2021.*

Në rast se situata me pandeminë Covid-19 vazhdon të mbetet e njëjtë edhe gjatë mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme në nivel lokal, numri i vëzhguesve të akredituar duhet të ulet, sidomos nga subjektet politike, kjo pasi që mundësia për përhapjen e virusit me një numër kaq të madh do të ishte tejet e lartë. Pa vënë në dyshim asnjëherë rëndësinë e vëzhguesve në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor si në ditën e zgjedhjeve poashtu edhe vëzhgimin e tyre aktiv në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si dhe Zyra për Regjistrimin e Partive Politike e cila shqyrton aplikacionet dhe miraton tek KQZ për aprovim, duhet të analizoj numrin e vendvotimeve dhe numrin e vëzhguesve/organizatave aplikuese dhe në bazë

të saj të caktoj edhe një tavan për secilin lloj se sa mund të jetë maksimumi i vëzhguesve të akredituar.

Përveç ditës së zgjedhjeve dhe numrit proporcional me vendvotimet, në QNR gjatë një dite nuk duhet të lejohen më shumë se 3 përfaqësues të një organizate vëzhguese (nga një për çdo ndërrim). Kjo si rezultat i numrit shumë të madh të stafit permanent dhe të rregullt në QNR si dhe hapësirës së ngushtë e cila nuk është e përshtatshme për punë në kohë të pandemisë.

## Organizimi i zgjedhjeve nga ana e KQZ-së

Zgjedhjet e mbajtura më 14 shkurt 2021 u cilësuan si demokratike dhe pa probleme të theksuara. Megjithatë KQZ përveç ditës së zgjedhjeve bën edhe menaxhimin e gjithë ciklit zgjedhor.

Për të evituar rrezikun e përhapjes së pandemisë COVID-19, KQZ miratoi udhëzimin administrativ për mbrojtje nga pandemia covid-19. Ky udhëzim kishte për qëllim që të përcaktoj zbatimin e masave mbrojtëse kundër infektimit me COVID-19 për votuesit dhe stafin zgjedhor në hapësirat ku mbahen zgjedhjet, duke përfshirë numërimin e fletëvotimeve në vendvotime dhe dorëzim-pranimin e materialit zgjedhor.

<sup>23</sup> Në udhëzim ishin të parapara masat mbrojtëse për stafin zgjedhor në hapësirat ku mbahen zgjedhjet; Masat mbrojtëse për votuesit gjatë procesit të votimit; Masat mbrojtëse gjatë procesit të numërimit në vendvotim; Dorëzim-pranimin e materialit zgjedhor nga Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Komisionin Komunal i Zgjedhjeve (KKZ); Dorëzimin e materialit sensitiv zgjedhor nga KQZ në QNR.

Ani pse ky udhëzim administrativ shërbeu edhe për zgjedhjet lokale të mbajtura në Komunën e Podujevës dhe Komunën e Mitrovicës së Veriut si dhe së fundmi për Zgjedhjet e

---

<sup>23</sup> [https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/1154-2020-Vendim-per-miratimin-e-udhezimit-adm-nr-03-2020\\_17-11-2020\\_1.pdf](https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/1154-2020-Vendim-per-miratimin-e-udhezimit-adm-nr-03-2020_17-11-2020_1.pdf)

Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në fakt nuk është që u mor parasysh as nga votuesit e madje as nga komisionerët dhe vëzhguesit.

KQZ gjithashtu miratoi Udhëzimin Administrativ për identifikimin, konfirmimin dhe votimin e personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 ishin në karantinë shtëpiake dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetë-izolimit. Ky udhëzim ka për qëllim që të përcaktojë mënyrën e regjistrimit të votuesve të infektuar me COVID-19, dhe atyre që ishin në vetë-izolim të cilët kanë vendbanim të përhershëm në komunat ku organizohen zgjedhjet; mënyrën e ofrimit të së drejtës së votës përmes ekipit lëvizës në ditën e zgjedhjeve dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve aty ku aplikohet; përshkrimin e hapave për aplikimin e masave mbrojtëse që duhet t'i respektojnë votuesit dhe anëtarët e ekipeve lëvizëse<sup>24</sup>.

Me këtë rast për zgjedhjet e 14 shkurtit KQZ siguroi 104 ekipe lëvizëse në tërë territorin e Kosovës të cilat u mundësuan qytetarëve që pavarësisht izolimit të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të votuar.

Diçka që nuk do të duhej të ndodhë në këto zgjedhje ishte ulja e numrit të vendvotimeve nga ana e KQZ-së nga 2,547 sa ishte në zgjedhjet paraprake të vitit 2019, në 2,382 në këto zgjedhje. Në fakt KQZ do duhej që të rris numrin e vendvotimeve në mënyrë që të shmangen grumbullimet dhe pritjet e gjata para vendeve të votimit të cilat rrezikuan përhapjen e pandemisë COVID-19.

Përveç numrit të vendvotimeve, do të duhej që edhe orari i votimit të zgjatet, kështu vendvotimet të mos mbylleshin në ora 19:00 por në ora 21:00. Meqë një praktikë e tillë nuk u bë në këto zgjedhje, të paktën në zgjedhjet e ardhshme në nivel

---

<sup>24</sup> [https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/1092-2020-Vendim-per-udhezim\\_al.pdf](https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/1092-2020-Vendim-per-udhezim_al.pdf)

-----

lokal do të duhet që të merret parasysh.

Dalja në zgjedhjet paraprake	826,916 votues (44.56%)
Dalja në zgjedhje gjatë pandemisë Covid-19	903,379 votues (48.78%)
Orari për votim para pandemisë	07:00-19:00
Orari për votim gjatë pandemisë	07:00-19:00
Numri i vendvotimeve para pandemisë	2,547
Numri i vendvotimeve gjatë pandemisë	2,382

## Rekomandimet

- › Situatat e jashtëzakonshme jo gjithmonë janë të rregulluara me ligje dhe rregullore të shteteve, andaj në raste të tilla siç është pandemia Covid-19 duhet të vepohet me maturi sidomos kur janë në pyetje zgjedhjet. Kredibiliteti i zgjedhjeve, besueshmëria e qytetarëve, procesi demokratik e transparent dhe shëndeti publik duhet të jetë primar në çfarëdo situatë.
- › Duke parë rrjedhën aktuale me pandeminë që ende nuk dihet se kur do të përfundoj, dhe se në situata të tilla do të mund të zhvillohen edhe zgjedhjet lokale në këtë vit, organet përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve duhet të:
  - Krijojnë një task forcë për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve në kohë të pandemisë Covid-19, e cila do të përfshijë ekspertë të ndryshëm rreth hartimit të planit të veprimit, monitorimit dhe zbatimit të tij;
  - Përgatisin një plan strategjik/udhëzues për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në kohë pandemie;
  - Marrin masa paraprakisht për organizimin e fushatës zgjedhore dhe tubimeve elektorale (duke zhvendosur fushatën online dhe lejimin e tubimeve në numër të vogël maksimum 5 persona, duke respektuar masat mbrojtëse – maskën dhe distancën);
  - Institucionet nënshkruese të memorandumit të bashkëpunimit të vazhdojnë bashkëpunimin edhe më të ngushtë jo vetëm ditën e zgjedhjeve por edhe gjatë fushatës zgjedhore dhe fazave të tjera përgatitore;

- Subjektet Politike të reflektojnë mbi atë se si është zhvilluar fushata dhe ndikimi negativ që ka pasur në rritjen e rasteve pozitive me Covid-19;
- Të ulet numri i vëzhguesve të akredituar, sidomos nga subjektet politike;
- Të sigurohet një hapësirë shtesë ose të reduktohet numri i të punësuarve dhe vëzhguesve në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve;
- Të zgjatet orari i votimit deri në ora 21:00;
- Të rritet numri i vendvotimeve nga ana e KQZ-së.



## Referencat

<https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkruhet-memorandum-i-bashkepunitimit-per-procesin-zgjedhor/>

<https://www.idea.int/news-media/multimedia-reports/global-overview-covid-19-impact-elections>

[https://www.ifes.org/sites/default/files/2016\\_ifes\\_serbia\\_parliamentary\\_elections\\_faqs.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/2016_ifes_serbia_parliamentary_elections_faqs.pdf)

[https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes\\_faqs\\_elections\\_in\\_serbia\\_2020\\_parliamentary\\_elections\\_june\\_2020.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes_faqs_elections_in_serbia_2020_parliamentary_elections_june_2020.pdf)

<https://www.idea.int/data-tools/country-view/253/40>

<https://www.idea.int/data-tools/country-view/253/40>

<https://crra.rs/wp-content/uploads/2018/03/PRELIMINARY-REPORT-ON-THE-ELECTION-DAY-OBSERVATION-2016.pdf>

<https://www.dw.com/sq/zgjedhjet-parlamentare-t%C3%AB-serbis%C3%AB-mbahen-edhe-n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-53880547>

<https://www.worldometers.info/coronavirus/country/serbia/>

<https://www.worldometers.info/coronavirus/country/serbia/>

<https://www.dw.com/sq/maqedoni-e-veriut-hapen-votimet-p%C3%ABr-zgjedhjet-parlamentare/a-5415484>

<https://www.aa.com.tr/en/europe/n-macedonia-holds-snap-polls-amid-pandemic/1909817>

<https://www.idea.int/data-tools/country-view/207/40>

<https://koronavirus.gov.mk/stat>

<https://koronavirus.gov.mk/stat>

<https://www.osce.org/files/f/documents/3/d/295511.pdf>

[https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes\\_faqs\\_elections\\_in\\_montenegro\\_2020\\_parliamentary\\_elections\\_august\\_2020.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/ifes_faqs_elections_in_montenegro_2020_parliamentary_elections_august_2020.pdf)

[http://archive.ipu.org/parline/reports/2385\\_E.htm](http://archive.ipu.org/parline/reports/2385_E.htm)

<https://www.idea.int/data-tools/country-view/203/40>



<https://www.worldometers.info/coronavirus/country/montenegro/>

<https://www.worldometers.info/coronavirus/country/montenegro/>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



## Lista e publikimeve

### Zgjedhjet dhe partitë politike:

#1 Instituti D4D. Shtator 2011 Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.

#2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?

#3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën

#4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?

#5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.

#6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero

#7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike

#8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje

#9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit

#10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi, Shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor

#11 Dr. Besnik Pula, maj 2018. Demokracia e Kosovës në

rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë.

#12 D4D, shtator 2018. Agjendë për reformën zgjedhore: Drejt përfaqësimit të vërtetë.

#13 D4D dhe Demokraci Plus (D+), tetor 2018. Votimi nga jashtë vendit: Shqyrtimi i politikave dhe rekomandimeve praktike.

Punime të fushave të tjera mund të gjeni në uebfaqen zyrtare **[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)**



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

324:005(047)

324: 616-036.22(047)

Zgjedhje në kohë pandemie : menaxhimi kundrejt pasojat / [përgatitur] Blerinë Ukshini. – Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2021. – 41 f. ; 21 cm.

1. Ukshini, Blerinë

**ISBN 978-9951-823-06-7**



Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një shoqëri aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë në hapësirën publike dhe e përdor atë për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e burimeve të cilat janë efçiente, të shpejta, afat-gjate dhe që sjellin zhvillim të paanshëm.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org).

Ky punim është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina

ISBN 978-9951-823-06-7



9 789951 823067